



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja: Nr. 23

Datë: 09. 04. 2024

Fillimi i takimit: Ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë

Kryesoi: Kreshnik Radoniqi, Kryesues i KQZ

Anëtarët e KQZ-së prezentë: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Fazli Stollaj

Nga SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ; **Nga ZRCKFSP:** Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP; **Përkthyes:** Argjina Misini; Jehona Cami; **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 20 dhe 21/2024
3. Aktivitetet e SKQZ
4. Aktivitetet e Zyrës:
 - Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve në procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave në Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, 21.04.2024 (Grupi I).
5. Raport i Këshillave të KQZ

5.1.Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për caktimin e numrit maksimal të votuesve në vendvotime, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut;
 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Certifikimit Listës Votuese, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut;
 3. Shqyrtimi i procedurës për përdorimin e kamerave në vendvotime;
 4. Shqyrtimi dhe miratimi i Procedurave të votimit dhe numërimit, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut;
 5. Shqyrtimi dhe miratimi i Formave Zgjedhore, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut;
 6. Shqyrtimi i Njoftimeve për informim publik, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut;
 7. **Të ndryshme**
-

1. **Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

Pas paraqitjes, agjenda u miratua me 11 vota. Po ashtu, në radhë u shqyrtuan dhe u miratuan me 11 vota për procesverbalet nr. 20 dhe 21/2024. Pastaj, u kalua në raportin e aktiviteteve të Sekretariatit mes dy takimeve.

2. **Aktivitetet e SKQZ:**

Burim Ahmetaj, tha se Sekretariati u ka dërguar ftesa Subjekteve Politike për nominime për anëtarët e Këshillit të Vendvotimit (KVV) dhe Ekipeve Mobile në katër komunat. Ftesat u janë dërguar të gjitha subjekteve politike të përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe në Kuvendet Komunale në Laposaviç, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë të Veriut, që t'i propozojnë në Komisionin Komunal

të Zgjedhjeve (KKZ) sipas komunave përkatëse, nominimet për anëtarë të Këshillave të Vendvotimeve (KVV) dhe KVV për Ekipet Mobile për procesin e votimit. Propozimet e subjekteve politike për anëtarë të KVV-ve duhet të bëhen në përputhje me kriteret e përcaktuara në Rregulloren Zgjedhore 11/2024 për Këshillat e Vendvotimeve.

Mirëpo, më 7 dhe 8 prill 2024 nga ZEKKZ –të Sekretariati ka pranuar dorëheqjet e anëtarëve të KKZ të përfaqësuesve nga lista serbe në katër (4) komunat dhe përfaqësuesi i KKZ nga GISPO në komunën e Mitrovicës së Veriut dhe lidhur me këtë Sekretariati ka dërguar shkresën për zëvendësimin e anëtarëve të KKZ-së, e ka informuar z. Ahmetaj KQZ-në.

Me datën 01.04.2024, është bërë kërkesa në departamentet e Agjencisë së Regjistrimit Civil për pajisjen me Ekstraktin e tretë dhe të fundit për procesin e votimit që do të mbahet më 21 prill 2024. Me datën 03.04.2024 nga dy departamentet kemi pranuar ekstraktet, me të dhënat e të gjithë shtetasve për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, të cilët janë të moshës 18 vjeç dhe mbi 18 vjeç, duke përfshirë edhe personat që deri me datën 21 prill 2024, mbushin moshën 18 vjeç. Pas pranimit të ekstraktit të tretë është bërë krahasimi i të dhënave mes ekstraktit të parë, të dytë dhe të tretë dhe ndryshimet mes ekstrakteve janë aplikuar në Listën e votuesve, në makinën kërkuese.

Kryeshedi Ahmetaj, tha po ashtu se, periudha për ndërrimin e qendrës së votimit ka filluar me datën 18.03.2024 dhe ka përfunduar me datën 03.04.2024. Gjithsej shërbimi votues ka pranuar dhjetë (12) kërkesa për ndërrimin e qendrës së votimit. Të gjitha kërkesat janë shqyrtuar dhe aprovuar.

Periudha e Regjistrimit të Votuesve jashtë Kosovës ka filluar me datën 29 mars 2024 dhe ka përfunduar me datën 5 prill 2024.

Përgjatë periudhës së aplikimit për regjistrim, përmes platformës elektronike, janë pranuar 2 kërkesa për regjistrim, të cilat janë aprovuar dhe të njëjtit janë informuar lidhur me statusin e aplikimit.

Zbatimi i periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit të LV-së ka filluar me datë 18.03.2024 dhe ka përfunduar me datë 05.04.2024. Sipas rregullores 03/2024 - Krijimi, Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës së Votuesve, Lista Preliminare e Votuesve bëhet publike në zyrat e KKZ, në formatin elektronik dhe në platformën elektronike.

Burim Ahmetaj, e informoi KQZ-në edhe për dërgimin e Listës Preliminare e Votuesve e cila, është bërë më 20.03.2024. Lista është dërguar në formatin elektronik (pdf) dhe po ashtu, bashkë me

formularin e ankesës. Të njëjtit, janë njoftuar që lista preliminare e votuesve duhet të përdoret vetëm për qëllim të njoftimit të votuesve.

Lista preliminare e votuesve është publikuar edhe në makinën kërkuese. Në ueb faqe të KQZ është publikuar formulari i ankesës dhe email adresa ku votuesit kanë pasur mundësi të dërgojnë ankesën. Përgjatë kësaj periudhe nuk kemi pranuar ankesë/ kërkesë për kundërshtim të Listës Preliminare të Votuesve. Ndër aktivitetet e tjera, sipas raportit të Sekretariatit, janë: Njoftim për të gjeturat nga draft Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) - pranuar me datë 05.04.2024); Raporti i Punës së KQZ për vitin 2023 për Kuvendin Kosovës – duhet të dërgohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës më së largu deri më 30 prill 2024; Pyetësori i vetëvlerësimit - duhet të dërgohet në Njësitin (Divizionit) Qendror Harmonizues për Menaxhim Financiar dhe Kontroll në Ministrinë e Financave më së largu deri më 30 prill 2024; Raportet tre mujore (T1) për periudhën 01 janar deri 31 mars 2024 dhe përfshin: 1. Plani i punës së KQZ për vitin 2024 (T1). 2. Pasqyrat financiare (T1). 3. Raport i shpenzimeve të derivateve të veturave (T1). 4. Raportim për planin e prokurimit (T1).

Kryetari **Radoniqi**, pyeti anëtarët nëse kanë ndonjë pyetje lidhur me raportin!

Sami Kurteshi, tha se Serpska Lista është tërheqë tërhequr. A e ka njoftuar KQZ-në sipas një rregulli, arsyetimi, apo këtë e ka bërë për marketing në OKB ? Opinioni është njoftuar përmes mediave, por KQZ-ja jo.

Burim Ahmetaj, informoi se KQZ me 7 dhe 8 prill, Sekretariati ka pranuar imell nga ZE për dorëheqjet nga katër komunitat për dorëheqjet e anëtarëve të Listes Serpska nga KKZ. Po ashtu, janë tërhequr edhe anëtarët e subjektit GI SPO-së. Ne u kemi dërguar letër SL dhe GI SPO, për zëvendësimin e tyre.

Ibrahim Selmanaj, tha se në lidhje me funksionimin e KKZ-ve, meqë kemi dorëheqjet, cili duhet të jetë veprimi ynë ?

Burim Ahmetaj, tha se KKZ-të janë funksionale, mirëpo ne kemi dërguar ftesën që të gjitha subjektet të jenë të përfaqësuar, dhe ne u kemi dërguar ftesën në mënyrë që vendet e tyre të mos mbeten vakant. Mirëpo, KKZ janë funksionale.

Sami Kurteshi: zyrtarisht, ata nuk janë tërhequr, kurse neve nuk na kanë njoftuar zyrtarisht, kurse ne u kemi dërguar letër...! Kujt i kemi dërguar ne letër, Listës Serpska. Është tërhequr ajo, apo jo...?

Alban Krasniqi: KQZ nuk vepron bazuar në deklarata, por vepron përmes komunikimit zyrtar. Rregulloret, parashohin procedurat strikte, si edhe në këtë rast...! KKZ-të, janë funksionale edhe tash,

mirëpo është në autoritetin e KQZ-së që, nëse mund të përfshihen anëtarë edhe nga shoqëria civile, kjo mund të ndodh por, pa e tejkaluar numrin e duhur. Kjo, edhe mund të ndodh...! Të tjerat për KQZ-në, janë irrelevante...

4. Aktivitetet e ZRCKFSP:

Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve në procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave në Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, 21.04.2024 (Grupi I):

Besnik Buzhala, drejtor i zyrës tha se perioda e aplikimit për akreditim të vëzhguesve ka filluar me 1 prill, dhe përfundon me 15 prill. Deri më 8 prill, kanë aplikuar 3 media (RTV Dukagjini, me 4 vëzhgues, Telegrafi me 3 vëzhgues, Arbresh.info me 3 vëzhgues) si dhe Ambasada e SHBA-ve me 4 vëzhgues. Sot, po ashtu kemi pranuar edhe 3 aplikime. Ne, rekomandojmë për akreditim grupin e parë të vëzhguesve.

Me 11 vota për, u miratua akreditimi i grupit të parë të vëzhguesve.

5. Raport i Këshillave të KQZ

Këshilli për Operacione Zgjedhore:

Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për caktimin e numrit maksimal të votuesve në vendvotime, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut:

Arianit Elshani, tha se KOZ-i ka shqyrtuar caktimin e numrit maksimal të votuesve në vendvotime. Ligji, përcakton që VV, përbëhet nga 750 votues. Kemi ardhë në përfundim që numri të rritet. Janë 87 Vendvotime në katër komuna, dhe kemi ardhur në përfundim që votimi të zhvillohet në 73 vendvotime. Duke rekomanduar po ashtu që, numri i votuesve të rritet maksimalisht: në 950.

Me 10 vota për, dhe 1 abstenim, miratohet rekomandimi.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Certifikimit Listës Votuese, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut:

Arianit Elshani, e informoi KQZ-në lidhur me raportin e Certifikimit të Listës Votuese. Përgatitja gjeneralë e listës, është në fazën e certifikimit. Z. Elshani, raportoi për numrin e votuesve për secilën komunë, dhe ai rekomandoi për certifikim.

Me 10 vota për dhe 1 abstenim, u certifikua lista e votuesve.

7. Shqyrtimi i procedurës për përdorimin e kamerave në vendvotime:

Gjithashtu, u miratua edhe vendosja e kamerave në VV, me 10 vota për dhe 1 abstenim. Kjo u bë lidhur me ngritjen e transparencës, me rritjen e efikasitetit të procesit, me monitorimin e punës së komisionerëve etj.

Me 10 vota për dhe 1 abstenim, u certifikua lista e votuesve.

8. Shqyrtimi i Njoftimeve për informim publik, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut:

Z. Elshani, e informoi KQZ-në lidhur me procesin e deritanishëm të informimit publik. U informua se, meqë nuk ka votues lidhur me votimin me postë, është rekomandim që të ndërpriten aktivitetet për votimin me postë.

9. Të ndryshme !

